

PERMBLEDHJE E KUSHTEVE PLOTESUESE PËR SIGURIMIN NGA AKSIDENTET (SIGURIM SHITESI I SIGURIMIT TE JETES ME KURSIM)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Këto kushte për sigurimin nga aksidentet si mbulim shtesë e sigurimit të jetes (këtu e më poshtë do të quhen “Kushte Plotësuese”) dhe janë pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit të jetes (këtu e më poshtë do të quhet “Kontrata”) që kontraktuesi/i siguruari ka nënshkruar me shoqërinë SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a (këtu e më poshtë do të quhet “sigurues”).
2. Sipas këtyre kushteve plotësuese mund të kontraktohet sigurim për rastet e:
 - a. paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme që rezulton nga aksidenti,
 - b. paaftësisë së perkohshme, të plotë ose të pjesshme që rezulton nga aksidenti

PERCAKTIME

“Dëm Trupor” do të konsiderohet dëmtimi fizik i identifikueshëm që:

- a. shkaktohet nga një Aksident
- b. shkakton vdekjen ose paaftësinë e të Siguararit brenda dymbëdhjetë muajsh nga data e Aksidentit, i vetëm dhe në mënyrë të pavarur nga çdo shkak tjetër.

“Aksident” do të konsiderohet një ngjarje e menjëhershme, e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa qëllimin e të Siguararit, që ka impakt të jashtëm direkt dhe të dhunshëm në trupin e tij dhe që rezulton në humbjen e jetës ose në paaftësinë e përhershme brenda 12 muajsh nga data e ndodhjes.

“Paaftësi e Plotë e Përkohshme” do të konsiderohet paaftësia që e ndalon të Siguararin tërësisht të kryejë veprimtarinë e tij ekonomike ose çdo lloj punësimi për një periudhë kohe minimalisht 3 (tre) dite dhe që mund të vazhdojë deri në 180 dite.

“Paaftësi e Pjesshme e Përkohshme” do të konsiderohet paaftësia që e ndalon të Siguararin të kryejë pjesë të rëndësishme të veprimtarisë ose punës së tij për një periudhë kohe minimalisht 3 (tre) dite dhe që mund të vazhdojë deri në 180 dite.

“Paaftësi e Pjesshme e Përhershme” do të konsiderohet paaftësia që e ndalon të Siguararin pjesërisht nga kryerja e një veprimtarie ekonomike ose pjesë të rëndësishme të punës së tij, që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe që në përfundim të periudhës së sigurimit është pa shpresë për mirësimi.

“Paaftësi e Plotë e Përhershme” do të konsiderohet paaftësia që e ndalon të Siguararin tërësisht nga kryerja e çdo veprimtarie ekonomike ose punë të çdo lloji, që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe që në përfundim të periudhës së sigurimit është pa shpresë për mirësimi.

“Humbje gjymtyre” do të konsiderohet humbja me ndarje fizike e një dore prej kyçit të dorës ose e një këmbë prej nyjes së këmbës dhe që përfshin humbjen e plotë dhe të pariparueshme të përdorimit të dorës, krahut ose këmbës.

PAGESA E PRIMIT

Primi sipas këtyre kushteve plotësuese paguhet bashkë me primin për sigurimin e jetes.

NJOFTIMI I AKSIDENTIT

Kontraktuesi, i siguruari ose përfituesi është i detyruar të njoftojë siguruesin për aksidentin brenda 7 ditësh nga dita e ndodhjes.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Për marrëdhëniet ndërmjet palëve kontraktuese të cilat nuk janë rregulluar me këto kushte plotësuese, zbatohet Kodi Civil.